

V E N D I M
Nr.575, datë 21.8.2003

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.796, DATË 24.12.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TË ARDHURAT E QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË (QKK), PËR SHPËRBLIMET E KËSHILLAVE MIRATUESE TË PROJEKTEVE TË KOMISIONIT TË VIZIONIMIT DHE KOMISIONIT FINANCIAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 40 të ligjit nr.8096, datë 21.3.1996 "Për kinematografinë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.796, datë 24.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:
"1. Pagesat (shpërblimet) e këshillave miratuese të projekteve:
- 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit artistik.
- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit dokumentar.
- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të këshillit miratues të projekteve të filmit vizatimor.".
 2. Pika 2 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:
"2. Shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar:
- 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit artistik.
- 8 000 (tetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit dokumentar.
- 8 000 (tetë mijë) lekë për sesion, shpërblimet e anëtarëve të komisionit financiar të filmit vizatimor.".
 3. Pika 3 e shkronjës "B" ndryshohet si më poshtë vijon:
"3. Shpërblimet e anëtarëve të komisionit të vizionimit:
- 2 000 (dy mijë) lekë për çdo vizionim filmi.".
 4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:
"3/1 Pagesat e shpërblimeve të ndryshojnë në përputhje me ndryshimin e indeksit të pagave në sektorin buxhetor.".
 5. Pas shkronjës "B" shtohet shkronja "C", me këtë përmbajtje:
"C. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano